



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:123341

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05422130

C.nr.211/2022

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshmen, gjyqtari Avdulla Mecinaj, ne çështjen juridike kontestimore te paditësit H.Z. me nr. personal... nga fshati..., komuna Skenderaj, te cilin me autorizim e përfaqëson Sh.A. avokat ne Mitrovicë, Rr..., kundër te paditurve D.D., A.D. nga fshati... dhe te paditurës H.D.-A., nga fshati..., komuna Skenderaj, për vërtetim pronësie, pas përfundimit te seancës kryesore publike me dt.28.02.2024 jep ketë.

A K T G J Y K I M
-Ne bazë te pohimit-

I. Aprovohet kërkesë padia e paditësit H.Z..

II .Vërtetohet se paditësi H.Z. nga i ati... është pronar i pasurisë e paluajtshme e cila evidentohet me nr. parcele P... ne sipërfaqe prej 00.02.90 ha, zona kadastrale ne...

III. Te paditurit D.D., A.D. dhe H.D.–A., u pajtuan qe paditësi H.Z. te beje regjistrimin e te drejtës se pronës si pronar i paluajtshmerisë si ne piken II, ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, ne Drejtorin për Kadaster Prone dhe Gjeodezi, komuna Skenderaj, në afat prej 15 dite.

IV. Anulohet masa e sigurisë e caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.211/2022 i dt:25.08.2022 dhe njoftohen Zyrtar Noteriale e Regjionit te Prishtinës ne Glllogoc, qe ketë ta evidentoni ne regjistrat përkatëse te tyre.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi H.Z. përmes te autorizuarit ka parashtruar padi ne ketë gjykate me dt.15.06.2022, kundër te paditurit D.D. nga fshati... për anulimin e aktvendimit mbi trashëgimi dhe vërtetimin e ekzistimit te drejtës ne prone me propozim për caktimin e masës se sigurisë.

Gjykata me aktvendimin C.nr.211/2022 te dt:25.08.2022 ka caktuar masën e sigurisë. Ne seancën e shqyrtimit kryesor i autorizuari i paditësit deklaroi se ne mënyre te detajuar kemi përshkruar ne padi se si është krijuar baza juridike dhe kjo paluajtshmeri është legalizuar edhe me kontratën e vitit 1988 e cila është vërtetuar përmes gjykatës kompetente, dhe paditësi ka hyre ne posedim faktik dhe juridike dhe ne autoritetin e atëhershëm komunal është bere regjistrimi i

pronës ne emër te paditësit i cili e ka skicën e planit me te dhëna sa i përket numrit te parcelës kadastrale dhe sipërfaqes se objektit kontestues, pra te gjitha këto janë te sublimuara ne petitumin e dispozitivit te padisë, qe do te nxjerr gjykata me aktgjykim ashtu qe te pranohet ne teri e bazuar, dhe i propozomi gjykatës pasi qe te paditurit e pohuan kërkesën e padisë te anulohet masa e sigurisë e caktuar nga ana e gjykatës për ketë çështje sepse konsideromi se kanë pushuar rrethanat për te cilat është i caktuar.

Te paditurit D.D., A.D. dhe H.D.-A. u deklaruan se ne jemi trashëgimtar tani te ndjerës gjyshes Sh.D. dhe prona e cila është objekt shqyrtimi ne paditësit nuk ja mohomi ketë te drejtë, pra e pohomi kërkesën e padisë.

Me nenin 148.1 te LPK, është përcaktuar ne qoftë se i padituri deri ne përfundimin e shqyrtimit kryesor te çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep pa shqyrtim te mëtejme aktgjykimin me te cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykim ne bazë të pohimit)

Duke u bazuar ne nenin 148.1, e lidhur me nenin 313.2 te Ligji i Procedurës Kontestimore, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe e miratoi kërkesëpadinë si te bazuar dhe e anuloi masën e sigurisë pasi qe kanë pushuar rrethanat për te cilën është caktuar.

Për shpenzime procedurale u vendos ne baze te nenit 450 te LPK.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.211/2022 me dt.28.02.2024

Gjyqtari,
AvdullaMecina

UDHËZIME JURIDIKE: Palët u deklaruan një zëri qe hjekun dore nga e drejta e ankesës ne aktgjykim i cili behet i plote fuqishëm me dt:28.02.2024.